

K R I T I K E E B I B L I O G R A F I

NJË POEMË ARBËRESHE PËR SKËNDERBENË

«Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë»

Afro tetëdhjetë vjet më parë poeti arbëresh Binard Bilota i dha dorën e fundit një poeme prej dymbëdhjetë kangjelesh për Skënderbenë dhe e shënoi titullin e saj në faqen e fundit të mbulesës së veprës së vet «Vjershe të përllipëm» (Versi lugubri) (1894) në radhën e librave që mendonte të botonte. Por, as me gjallje të poetit, as shumë vjet pas vdekjes së tij, vepra nuk e pa dritën e botimit. E ruajtur prej të afërmve dhe e përgatitur për botim prej stërnipit të poetit, studjuesit të palodhur arbëresh Emanuil Jordanit, nën kujdesin e sektorit të historisë së letërsisë shqipe të Institutit të historisë dhe të gjuhësisë, vepra u botua në atdhenë e stërgjyshërve të poetit, në vitin jubilar të vdekjes së Skënderbeut. Botimi i kësaj vepre përshëndetet tek ne, jo vetëm për kontributin që sjell ajo në pasurimin e letërsisë sonë kushtuar figurës së Gjergj Kastriotit, por edhe sepse na rrit shpresën se në botën arbëreshe ka e do të ketë studjues të zellshëm e patriotë që ruajnë me dashuri e kujdes vlera të mbetura dorëshkrim nga brezat e poetëve që s'mundën t'i botonin, për t'i dërguar të «butthohen ndë jetë me dritë të re», siç dëshironte i djegur Bilota t'i shihte veprat e tij, në atdhenë e të parëve, në Shqipërinë e rilindur.

Poema «Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» (Shpata e Skënderbeut në Dibrën e Poshtme) zë vendin qendror në vargun e gjatë të veprave të shkruara prej Bilotës. Vetë fakti që poeti e ka mbajtur 20 vjet në dorë e i është kthyer katër herë, provon se ç'vend i ka dhënë ai në krijimtarinë e tij kësaj vepre.

Kjo poemë e gjatë prej rreth 10 mijë vargjesh është si një kurorëzim i idesë patriotike që nxiti e frymëzoi tërë jetën Bilotën, i cili ju kushtua me pasjon e dashuri çështjes atdhetare, duke u shquar si mbledhës i folklorit e si studjues i traditës arbëreshe, si lëvruer i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe. Vepra nuk mund të kuptohet e shkëputur prej atij ideali fisnik që frymëzonte poetin për të lartësuar krenarinë kombëtare, për të forcuar ndërgjegjen patriotike e urrejtjen ndaj pushtuesit, as prej atij nderimi e dashurie të rrallë që kish Bilota për «të bukurën» e «të gjithë-shënjëtën» gjuhën shqipe. Në të parën veper që boton në arbërisht «Vjershe të përllipëm» (të hidhëruara), ndonëse përfshin në të dy tubëza tingëllimash elegjiake kushtuar mbesës e motrës së vdekur, Bilota me dy sonete që prijnë secilën tubëz ngre lart gjuhën arbëreshe që «është drita dhe gjëja më e mirë e qenjes së vet» dhe shpreh shqetësimin për faktin e saj në brezat e ardhshëm, kur sheh se një pjesë arbëreshësh i vuri poshtë «mjalti Dialit ljtii» («mjalti i gjenisë italiane»). Për t'i ardhur në ndihmë kësaj gjuhe që të mos humbasë, megjithëse e kërcënuar nga një rrezik i madh, atë e frymëzonte e i jep guxim emri e koha e Skënderbeut. Në njërin prej soneteve që përmendëm më lart, autori shkruan se për të kënduar arbërisht «i dha guxim ajo zemër trime, objekt i dashurisë së vet, që spikat aq bukur midis burrave të motit të tij, të cilëve ua kalonte si yjeve dielli, që mbi të gjithë shkëlqen». S'ka dyshim se, ndonëse s'përmend emrin, fjala

është për Skënderbenë. Shembulli heroik i qëndresës shqiptare në shekullin XV dhe kujtimi i Skënderbeut u bë një forcë e madhe, që i frymëzoi arbëreshët t'i rezistonin asimilimit italian dhe të ruanin individualitetin e tyre etnik.

Vepra «Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» vjen pas poemave të De Radës dhe para epopesë së Naimit. Ajo është shkruar kryesisht në vitet 70, në atë kohë kur lëvizja kombëtare për çlirim në Shqipëri zien gjersa arrin apogjenë e saj me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit, e kur bota arbëreshe mban lidhje të ngushta me këtë lëvizje, duke qenë e pushtuar nga idetë e reja të lirisë e të çlirimit kombëtar. Ky moment pasqyrohet në poemë përmes frymës së flaktë patriotike që e përshkon, përmes tonit kushtrues e apostrofave patetike që vlojnë nga një zemëratë e urrejtje e papërmbajtur ndaj pushtuesit.

«Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» paraqet një episod nga epopeja shqiptare e shek. XV, atë të ndeshjes së parë midis shqiptarëve dhe turqve, ndeshje që njihet me emrin beteja e Torviollit. Por, megjithëse vepra nuk pasqyron tërë historinë e luftimeve fitimtare të heroit tonë, duke zgjedhur një çast të tillë si beteja e Torviollit, ku u manifestuan vetitë e larta të shqiptarëve dhe aftësitë gjeniale të Skënderbeut si strateg e prijës popullor, Bilota evokon traditat më të çmuara të epokës që lidhet me emrin e Gjergj Kastriotit, si traditën e luftimeve lirishtarë të popullit tonë, traditën e qëndrimit trimëror dhe të papërkulur përpara një armiku shumë herë më të fuqishëm, duke u mbështetur në burimet e brendshme dhe në forcat e veta, traditën e bashkimit luftarak të forcave të mbarë popullit nën flamurin e luftës për liri. Evokimi i këtyre traditave merrte një tingëllim aktual në kushtet kur u shkrua poema e kur përtëritja e tyre ishte jetike për fatet e lëvizjes sonë për çlirim.

Vetë materiali që ka zgjedhur autori për veprën e vet, vetë ngjarja që vë në themel të saj e vendi që i jep paraqitjes së skenave të luftës, është përcaktuar nga dëshira për të hymnizuar vetitë e rralla të Skënderbeut dhe të shqiptarëve si luftëtarë trima e të pathyeshëm, të paisur me fuqi herë-herë të jashtzakonshme morale e fizike, e për të provuar se me zemrën dhe krahun e fortë fitohen beteja si ajo që u zhvillua në sheshet e Dibrës, ku shqiptarët shpartalluan një ushtri shumë herë më të madhe e më të paisur. Aq i prirë është autori për të paraqitur Skënderbenë dhe shokët e tij sidomos si luftëtarë, sa që në dy kangjelet e para, nga 12 kangjelet e poemës, përshkruan përgatitjet e shqiptarëve për t'i rezistuar mizorisë turke dhe në gjashtë të tjerat aspekte të një dite luftimi midis shqiptarëve dhe turqëve, ku shkëlqen gjithmonë lavdia e armëve shqiptare. Para syve tanë kalojnë njëri pas tjetrit pashallarët dhe komandantët turq të prerë prej shtatës së Skënderbeut e të trimave të tij, përsëriten ndeshje e dyluftime të përgjakshme. Po t'u shtojmë këtyre dhe këngën më vete, ku si në një prolog ekspozohet forca e madhe fizike dhe trimëria e pashoqe e Skënderbeut në dyluftimin me tartarin, del se poema është tepër e ngarkuar me skena dyluftimesh e përlëshjesh, që ndryshojnë pak nga njëra-tjetra. Vetë poeti si duket e ka ndërjerë këtë dhe ka dashur ta thyejë monotoninë duke futur linjën e dashurisë së Nderushit, një prej trimave të Skënderbeut, me Judhitën, si dhe episodin e dashurisë tragjike të turkeshës Xoraidha, që vjen në sheshet e Dibrës të kërkojë të vluarin e saj e bije robinë në duart e Nderushit, kur ka marrë vesh për vrasjen e të vluarit.

Notat e freskëta që sjellin këngët e mallit të Nderushit, të ndërtuara aq bukur në frymën e këngëve popullore dhe veprat lirike të botuara prej Bilotës, të shtyjnë të mendosh se mundësitë e poetit kanë qenë më të mëdha në fushën e lirikës e se ai ju vu punës për të krijuar një poemë epike të karakterit heroik romantik i shtyrë nga dëshira për t'u kënduar të bëmave të lavdishme të Skënderbeut i cili, si thuhet në tingëllimin I, «gjithë të lashtit burra Arbëreshë shkon».

Figura e Skënderbeut është vënë në qendër të veprës. Ai është paraqitur me tiparet e udhëheqësit të shquar popullor, të luftëtarit trim. Farkëtues i bashkimit

luftarak të princërve dhe popullit, shpirti i qendresës shqiptare, Skënderbeu gjendet kudo dhe kurdo aktiv në përgatitjet e betejës dhe në vlakun e luftës. Me shpatën e tij që shkrepëtin si «ill me bishtin» ai farkëton fitoren dhe me fjalën e urtë zgjon forca të pashtershme morale. Përmes ligjeratave që mban Skënderbeu para popullit dhe princërve, një mjet i shfrytëzuar gjerësisht prej autorit, zbulohen ti-paret e heroit, paraqitet besimi i tij në fitoren mbi armiqtë, që buron nga vetëdija e luftës së drejtë që bën populli i vet. I rrahur në valët e luftës, edhe pas fitores së madhe, ai porosit bashkëluftëtarët të ruajnë vigjilencën e ta mbajnë shpatën në mill.

Megjithse në vazhden e përgjithshme të traditës së letërsisë arbëreshe të gjeratëhershme për Skënderbenë, madje nën ndikimin e asaj tradite, vepra e Bilotës largon prej saj në disa pika, jo vetëm se e vuri në qendër figurën e Skënderbeut e se ndoqi pak a shumë historinë duke paraqitur njerën nga betejat më zulumë-mëdha të heroit, por edhe se në këtë vepër gjeti shprehje ndikimi i fortë i letërsisë klasike, sidomos i letërsisë mesjetare klerikale e i poemave kalorsiake. Ky ndikim ndjehet si në strukturën dhe në stilin e veprës, ashtu dhe në brendinë dhe, së bashku me botëkuptimin mistiko-fetar të autorit, nuk mund të mos ishte një pengesë në pasqyrimin me vërtetësi të figurës dhe të epokës së Skënderbeut. Poema e Bilotës, duke paraqitur në një krah anën e fortë patriotike të veprës së Skënderbeut, e në krahun tjetër duke trashëguar konceptin e historiografisë së kohës për Skënderbenë, që e paraqiste atë si kalorës të fesë, vuan nga një kontradiktë e brendshme.

Por, megjithë kufizimet ideore dhe vërejtjet që mund t'i bëhen nga pikëpamja e realizimit artistik, vepra e Bilotës paraqet interes për vlerat e saj patriotike, në kuadrin e përpjekjeve të letërsisë sonë për të zgjuar vetëdijen kombëtare të shqiptarëve përmes evokimit të figurës dhe epokës së Skënderbeut. Interesit të saj historik, si një moment në procesin e zhvillimit të letërsisë patriotike tek arbëreshët, i shtohet edhe interesi i veçantë gjuhësor që ngjall vepra.

Botimi i poemës në vitin jubilar të vdekjes së heroit kombëtar, plotëson një detyrë jo vetëm ndaj lexuesit tonë të interesuar për trashëgimin letrar të së kaluarës, të pañjohur ende, por edhe ndaj poetit patriot Binard Bilota, që shkriu mbi këtë vepër shumë vjet të jetës së tij, të cilën ja kushtoi luftës për të parë «të dritësuer gjakun tënë e gjuhën tënë».

Jorgo Bulo

